

## NEKROLOGJIA

### ANDROKLI KOSTALLARI

(1921-1992)

Ëtë hënën mbrëma, më 23.III. aty rreth orës 22,00, përmes Radios Shqiptare, mësuam për kumtin mbi vdekjen e Prof. Androkli Kostallarit, për lajmin që jehoi pikëllueshëm tek punonjësit dhe inteligjencia shqiptare, ndër studentë dhe arsimtarë të të gjitha moshave, tek veprimtarët e shkencave gjuhësore albanologjike.

Tash dyzet vjet Androkli Kostallari qëndron i patundur në jetësimin e çështjes kardinale të lëvizjes gjuhësore shqiptare, veprimtarët dhe militantët e së cilës më se një shekull me mund e jo pa viktima rreken ta krijojnë, ta arrijnë njësimin e gjuhës letrare shqipe.

Mësimet e para Androkliu i ri kishte zënë në Përmet, të mesmet i mbaroi në gjimnazin klasik të Shkodrës. Pas luftës çlirimtare në të cilën mernte pjesë që nga ditët e para, Kostallari regjistrohet në fakultetin filozofi-filologji të Universitetit të njohur e të çmuar të Moskës "Lomonosov". Si në shkallët e para të shkollimit, edhe në mesimet universitare, Androkliu shquhet për zell duke u dalluar, me ç'gjë bie në sy tek profesori i tij Vinogradov, i cili studentin e diplomuar mendonte ta merrte asistent në katedrën e gjuhësisë. Androkliu i shprehu profesorit të vet falënderimet e ngrohta e miradi të sinqertë, por parapëlqeu të kthehet në Shqipëri.

Që nga vitet e pesëdhjeta, pasi kthehet në atdhe, Androkliu hyn në radhën e filologëve të rinj, që po merrnin barrën e rëndë, por të shenjtë të organizimit e të krijimit të institucioneve kulturore e shkencore - bërthama të ardhshme të universitetit dhe të instituteve shkencore. Në saje të talentit dhe të aftësive organizative, Androkliut i besojnë detyra në udhëheqjen e Institutit histori-filologji në krye të të cilit do të qëndrojë me dekada. Ky Institut shpejt e merr veten dhe pas një kohe relativisht të shkurtër ia del të bëjë projekte me rëndësi kombëtare, sikur janë projekti për regjistrimin, grumbullimin dhe vjeljen e lëndës dialektologjike në gjithë territorin brenda shtetit dhe jashtë tij; projekti i studimeve arkeologjike, të cilat në kohë të regjimeve të mëparshme i bënin të huajt; me organizimin e ekspeditave kërkohet të zbulohen dëshmitë lëndore të kulturës së hershme ilire, shqiptare. Në saje të punës paraprake me rëndësi të madhe për kulturën kombëtare, Instituti zuri shpejt të orgnaizojë, njëherë pas tjetrës, konferenca albanologjike në shkallë kombëtare, në të cilat merrnin pjesë me interesim të madh edhe specialistë dhe studiues të huaj. Tirana po bëhej qendra e studimeve albanologjike që në të kaluarën ishte jashtë, në Austri e në qendra të tjera të Evropës Perëndimore.

Po interesimi personal i Androkli Kostallarit cili ishte?

Ç'është e drejta, profesorit të ri Kostallari, punët organizative i hanin shumë kohë; megjithatë interesimi i tij përqëndrohet kryekrejt në dy degëzime albanologjike, do të thoshim në dy fronte shkencore: në studimin e gjuhës letrare, në një anë, dhe në anë tjetër gjurmon mënyrat me produktive e më aktive të pasurimit të leksikut të shqipes së folur e të shkruar dhe të zhvillimit të sistemit të saj fjalëformues e gramatikor; për të qenë më të përpiktë, ai gjuan me përgjegjësi të ndërëgjegjeshme studimin e formanteve të kompozimit të fjalëve në shqipen - të lënë anash nga studiues albanologë.

Kostallari kishte vënë re shpirtin dinamik të shqipes në pasurimin e saj, sidomos me sufiksimin dhe kompozimin e fjalëve; në studimet e tij Kostallari rrihte të ndiqte fillin e këtij "demoni" të brendshëm të shqipes, që i jep asaj shkas e mundësi në pjellorinë e gjuhës sonë. Studimet e Kostallarit të këtij lloji janë të thella e të themelta, që mbeten gjedhe si duan trajtuar problemet e tilla të gjuhës.

Po gjuha letrare shqipe? Ajo, ishte tema më e preferueshme e Kostallarit. Asaj ia kushtoi një jetë të tërë njeriu, shkencëtari. Tok me bashkëpunëtorët e tij, pas përgatitjeve të domosdoshme paraprake, Kostallari arriti të organizojë Kongresin e Drejtshkrimit (1972) që trajtoi gjuhën letrare shqipe dhe problemet themelore të drejtshkrimit të saj. Kur është fjala te gjuha letrare shqipe e epokës sonë, ajo, sikundër dihet, miratimin e kishte marrë këtu tek ne, në Konsultën gjuhësore të Prishtinës (1968), pastaj në mënyrë të prerë e përfundimisht u sanksionua në Kongresin e Drejtshkrimit, që, e stabilizuar njëherë e mirë, po zbatohet gjithandej në kontekstet kulturore e shoqërore shqiptare.

Drejtësia teorike e gjuhës letrare shqipe u vërtetua edhe nga fakti që shumë rrethe shkencore iu drejtuan Prof. Kostallarit, që i ftuar, të vizitonte qendrat e tyre shkencore dhe atje të paraqiste parimet dhe metodën e zbatuar në zgjidhjen e gjuhës sonë letrare. Universteti i Geteborgut të Suedisë e nderoi duke i dhënë titullin e doktorit të shkencave filologjike për kontributin e dhënë në fushën e gjuhësisë e sidomos për teorinë e gjuhës letrare.

Nga vitet e shtatëdhjeta Kostallari u mbante leksione pothuajse rregullisht studentëve pasuniversitarë të dy degëve të gjuhës e të letërsisë shqipe të Universitetit të Prishtinës; shumë studentë në studime të shkallës së tretë prof. Kostallarit e kishin udhëheqës për tema nga gjuha letrare shqipe; ndihmën e tij studentët e mirëprisnin, të cilën ai çdoherë ua jepte pa përtuar.

Brezi i Kostallarit me të cilin lidhen aq shumë nisma e aq shumë rezultate në punën e ndriçimit të trashëgimisë lëndore e shpirtërore të popullit tonë - këto kohë të fundit ka zënë të rralohet; para sa ditësh na la Qemal Haxhihasani, një punëtor i zellshëm i studimeve të folklorit shqiptar.

Vdekja e papritur, e hershme e Androkli Kostallarit varfëron kulturën shqiptare, e në mënyrë të veçantë gjuhësinë shqiptare. Te Prof. Androkli Kostallari kulturës dhe gjuhësisë shqiptare i kpretutet një krah i fortë, vepra e të cilit do të mbetet e gjallë ndër ne si sot, si në ditët që do të vijjnë.

**IDRIZ AJETI**  
**Instituti Albanologjik i Prishtinës**

**AGNIA VASILJEVA DESNICKAJA**

(1912-1992)

Këto ditë me rrugë të tërthortë morëm vesh për vdekjen e albanologes së shquar Agnia Desnickaja; kumti mbi zhdukjen e saj pikëlloi thekshëm të gjithë ata që kishin pasur rast ta njihnin, e veçanërisht veprimtarët e shkencave albanologjike.

Pas Çabejt, Desnickaja është pothuajse një nga të sprasmet e atij brezi albanologësh që në truall të studimeve albanologjike zunë të veprojnë që para Luftës së Dytë Botërore, duke çuar përpara studimet e gjuhësisë shqiptare.

Para revolucionit të Tetorit në Rusinë Cariste nuk ka pasur, pothuajse, emra të dalluar, e as shkencë të vërtetë albanistike. Përpykjet sporadike që mund të ndeshen janë të papërfillshme.